



01/Nr. 3872/2023  
Data : 10.05.2023

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e katër -IV- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa , mbajtur me datë 18.04.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), **Rezart Mehmeti** ( Përfaqësues i OSB-së).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të rregullta të rendit të punës të cilat i kemi përcjell kemi edhe një pikë të rendit të ditës të cilën propozoj që të hynë në rend të punës Kërkesa e znj.Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Kërkesa e znj.Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.
6. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2023 është në shumë prej 3,349,715.00 €, në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 438,190.62 € apo 25.73 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 56,767.57 € apo 12.21%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 20,428.74 € apo 21.17 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 3,400.00€ apo 3.40 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 2,540.00 € apo 0.26 % . Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2023 është në shumë prej 521,326.93 € apo 15.56%. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 43,749.54 € të hyra vetanake për periudhën janar-mars 2023 të planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi një rënie në shumë për 21,495.36 €.

**Refet Kalisi** thekson:- të hyrat vetanake për tre mujorin e viti 2023 janë më të vogla se në tre mujorin e vitit 2022.

**Lindita Ballazhi** thekson:- sipas mendimit tim mund të jetë shkak i tatimit në pronë që ishte në media për faljen e tatimit në pronë dhe kjo ka ndikuar te qytetarët që mos të paguajnë tatim në pronë

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTU RAPORTI FINACIAR PËR PERIUdhËN JANAR-MARS 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 3. Informatë për ndarjen e bursave.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sherif Berisha** thekson:- është bërë mirë që janë përfshirë studentët edhe nga Maqedonia Veriore dhe kam dëgjuar fjalë të mira dhe nëse kemi mjete financiare është mirë me rritur numrin.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTU INFORMATI PËR NDARJEN E BURSAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

#### 4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi** thekson:- ekonomitë familjare a i kanë borxh kompanisë .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- me sa jam njoftuar e di që ka borxhe por janë rastet të cilat janë me social. Mundësi me fal borxhe nuk kemi për shkak se Ligji nuk e lejon por në të ardhmen duhet me shikuar një formë se si me vepruar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR –MARS 2023 I N.P.L PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 5. Kërkesa e znj.Hanushe Dernjani për ndërrim destinimin e pronës.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Abduraman Bushi** thekson:- kemi pranuar një kërkesë nga znj.Hanushe Dernjani për ndërrim destinim të parcelës për ndërtimin e një shtall. Për ndërrim destinim kërkohen 700 m<sup>2</sup>. Për mbledhje të kuvendit do tu a sjelli materialin të kompletuar.

**U VOTU KËRKESA E ZNJ.HANUSHE DERNJANI PËR NDRRIM DESTINIMIN E PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 6.Të ndryshme

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- ndihmat që do të ndahen sot nëse ka mjaftueshëm propozoj që 100 paketa të ndahen për kategoritë e dalura nga lufta.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- paketat janë ardhur nga Katari dhe ata kishin kriter që gjatë ndarjes secili me qenë prezent sepse po t’i kishin lënë me i shpërndarë komuna atëherë së bashku me qendra për punë sociale do t’i kishim shpërndarë edhe për ata familje që nuk janë raste sociale dhe kanë nevojë për ndihmë. Sa i përket ndihmave për veteranë kush do që ka nevojë do të mundohemi edhe prej komunës me i ndihmuar dhe nëse e identifikoni dikend është mirë me najë paraqitur si rast.

**Kryesuesi** thekson:- është mirë që edhe me administratorët e fshatrave me pasur kontakte për shkak se ata kanë njohuri më shumë për fshatrat e tyre.

**Natyra Kalisi** thekson:- janë edhe administratorët e këshillave të fshatrave, qendra për punë sociale dhe drejtoresha për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

**Hisni Luri** thekson:- me që kam ardhur me vonesë deshta të ju njoftojë për festivalin mbarë kombëtarë Hani i Elezit që do të mbahet në muajin Qershor me datë nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë qershor. Materialin do tu a përcjellim për mbledhje të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi** thekson:- si është bërë përzgjedhja e nxënësve në aktivitetin që po mbahet drejtë malit. Kërkoj informacion për katër nxënësit të cilët kanë qenë në Turki.

**Hisni Luri** thekson:- drejtë malit është një projekt që e ka Ministria e Arsimit së bashku me federatën e sportit. Është e përcaktuar një klasë dhe tash është klasa e shtatë e me që jemi vend i vogël jemi munduar me bërë gjithë përfshirje prej gjitha klasave të shtata . Nxënësit të cilët janë përzgjedhur prej pedagogëve të sportit dhe si drejtor i arsimit nuk ju kam përzierë në këtë çështje dhe u a kam lënë personave kompetentë për me bërë këtë përzgjedhje . Janë përzgjedhur në bazë të kujdestarëve të klasave, pedagogëve të sportit por nuk ka lidhje me suksesin e tyre. Nxënësit të cilët ishin në Turki janë kthyer dhe do ta vazhdojnë mësimin në shkollat të cilët kanë qenë dhe në rast se kanë humbur shumë mësim do të vazhdojnë me provime.

**Kryesuesi** thekson:- pavarësisht atë që e potencove për këtë çështje ka pasur ankesa dhe ka qenë mirë me marr pjesë edhe këshilli i prindërve në këtë çështje në mënyrë që në të ardhmen mos me pasur ankesa.

**Sherif Berisha** thekson:- a ka ndonjë arsye që janë kthyer ata nxënës për shkak se janë përzgjedhur për shkuar atje.

**Hisni Luri** thekson:- arsyeja e kthimit është për shkak se kanë qenë të rinj dhe janë mërztitur, ndërsa për pjesën se si kanë shkuar e kemi diskutuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- arsyeja e kthimit është për shkak se nuk kanë mundur me i qëndruar rregullave dhe nuk janë vetëm të komunës sonë por janë edhe të komunave të tjera që janë kthyer dhe janë vetëm pesë apo gjashtë nxënës të cilët kanë mbetur atje.

**Sherif Berisha** thekson:- në fund javë e patëm një protestë për çështjen e rrugës Hani i Elezit – Gorancë, a keni diçka konkrete në këtë drejtim.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë edhe në protestë jam deklaruar se e mbështesë protestën dhe kemi dërguar shkresa në Ministri të Infrastrukturës për këtë çështje dhe gjatë takimeve që i kemi pasur e kemi diskutuar dhe sipas bisedave të cilat i kemi pasur deri në muajin qershor kompanisë i kanë dhënë afat që me i filluar punimet dhe nëse në qershor nuk fillojnë punimet do ta diskualifikojnë atë kompani dhe fillojnë procedura të tjera .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:46.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**

